

ARBËRIT DHE BIZANTI GJATË MESJETËS (XI-XV)

(Muhamet Qerimi, *Arbërit dhe Bizanti gjatë Mesjetës (XI-XV)*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2017, f. 372)

Studimi monografik “Arbërit dhe Bizanti gjatë mesjetës (shek. XI-XV)”, i autorit prof. asoc. dr. Muhamet Qerimi është një ndihmesë e re kushtuar historisë së mesjetës. Në këtë vepër autori trajton ngjarje mjaft të errëta dhe në të njëjtën kohë shumë të rëndësishme të cilat për t’i ndriçuar i është kushtuar një punë e gjatë hulumtuese e dokumentacionit arkivor të cilin autori e ka realizuar me sukses. Gjatë elaborimit të materialit në dispozicion, kjo problematikë është pasqyruar me objektivitet në tërë kompleksivitetin e ngjarjeve. Monografia studimore “Arbërit dhe Bizanti gjatë mesjetës (shek. XI-XV)”, është rezultat i një pune kërkimore-shkencore disavjeçare që ka për qëllim të hedhë dritë në një periudhë mjaft të errët të historisë arbërore dhe bizantine.

Për periudhën në fjalë (shek. XI-XV) në historiografinë arbërore ende nuk ka ndonjë punim kompakt. Autorë të ndryshëm i kanë trajtuar këto marrëdhënie kryesisht në kuadrin e studimeve të përgjithësuar. Kurse në kuadrin e studimeve të veçanta ka shumë pak studime që i kushtohen drejtpërsëdrejti marrëdhënieve të Bizantit me arbërit. Konsultimi me burimet dhe literaturën e botuar më krijoi bindjen se për këtë periudhë kishte ende shumë vend për të hedhur dritë për aspekte të ndryshme. Njëherësh me këtë arritëm në përfundimin se një temë studimore që të kapte në mënyrë tërësore problemin shqiptar në marrëdhëniet me bizantinët do të ishte një kontribut modest për historinë e popullit tonë. Mbështetur në këto argumente, si dhe në hulumtimet tona studimore, është shfrytëzuar një literaturë e gjerë. Vëmendje të veçantë autori i kushton burimeve të botuara dhe literaturës së përzgjedhur. Në këtë kategori burimesh dominojnë ato që ka vjelë nga Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë. Burimet bibliografike janë shfrytëzuar në biblioteka të ndryshme, brenda dhe jashtë Kosovës. Midis tyre më duhet të përmend: Bibliotekën Universitare të Vjenës, Bibliotekën Kombëtare të Tiranës, Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Bibliotekën e Fakultetit Filozofik, Prishtinë, Bibliotekën e Institutit Albanologjik, Prishtinë, Bibliotekën e Institutit të Historisë, Tiranë etj.

Tërësia e burimeve është trajtuar mbi bazën e kriterëve shkencorë, duke i ndarë në burime parësore dhe dytësore. Duke u mbështetur në tërësinë e bazës burimore dhe sidomos në punën hulumtuese të autorit, kështu monografia është ndarë në katër kapituj, të paraprirë nga një parathënie dhe të shoqëruar në fund nga përfundimet. Në kapitullin e parë të titulluar “Marrëdhëniet politiko-shoqërore në Perandorinë Bizantine gjatë shek. XI-XV”, autori jep një pasqyrë të përgjithshme të Perandorisë, në të cilën përfshiheshin dhe tokat arbërore. Krahas këtij synimi ky kapitull në vija të përgjithshme shërben edhe si një kapitull hyrës.

Kapitulli i dytë “Arbërit në burimet bizantine të shek. XI” është një nga kapitujt themelor. Jo rastësisht është zgjedhur ky shekull. Në kuadrin e tij ndodhën mjaft ngjarje të natyrave politike, ekonomike, fetare, kulturore etj., të cilat sollën ndryshime, si në rrafshin perandorak, ashtu edhe në tokat arbërore. Nga ky shekull dhe në vazhdimvërehet një intensitet në rritje i burimeve bizantine për tokat dhe popullin shqiptar. Ndryshimet e përmendura janë konceptuar brenda kapitullit si sythe (nënkapituj). Në çdonjërin prej tyre është synuar të hidhet dritë apo të sqarohen probleme të rëndësishme që lidhen me historinë e popullit arbëror të këtij shekulli. Sythi i parë, i titulluar “Paraqitja e parë e arbërve në burimet bizantine”, ka pasur për objekt të japë një kuadër më të plotë rreth shfaqjes të emrit Arbanon. Ndërsa, situatat e tjera që u zhvilluan vrullshëm në këtë shekull dhe që prekën gjerësisht tokat arbërore janë trajtuar në sythet “Bizanti dhe arbërit në shek. XI” dhe “Roli i arbërve në kryqëzata”.

Në kapitullin e tretë që mban titullin “Formacionet shtetërore arbërore dhe raportet me Bizantin” është shumë i rëndësishëm, sepse nëpërmjet disa nënkapitujve autori ka trajtuar nga njëra anë përpjekjet dhe arritjet e parisë arbërore për të themeluar formacionet e veta shtetërore, kurse nga ana tjetër i është kushtuar kujdes marrëdhënieve që kishin këto shtete arbërore në mes vete dhe me Bizantin. Në këtë kapitull nuk është lënë jashtë vëmendjes edhe trajtimi i synimeve që kishin shtetet perëndimore dhe ato ballkanike ndaj viseve arbërore. Ndërsa, kapitulli i katërt dhe i fundit, merr përsipër trajtimin e ndikimeve të ndërsjella midis arbërve dhe bizantinëve në fushën e artit, gjuhës, ndërtimeve fetare e laike dhe kulturës në përgjithësi. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe pranisë së faktorit arbëror në këto fusha. Së fundi, autori përmes këtij studimi monografik ka dhënë një përmbledhje sa më sintetike të arriturave të gjertanishme të historisë së arbërve dhe marrëdhënieve të tyre me bizantinët në shek. XI-XV.

Fidan ZENELI

IN MEMORIAM